



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

A.nr.1668/14

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti për çështje administrative, Divizioni Fiskal, me gjyqtarin Krenar Berisha, dhe me procesëmbajtësen Nexhmije Abazxhik, në konfliktin administrativ, të paditësit B. shpk nga F. kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike: vlerësim i mallit doganor, në seancën publike të mbajtur me datë 23.09.2016, në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, e në mungesë të përfaqësueses ligjore të palës së paditur, mori këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET kërkesëpadia e paditësit B. shpk nga F.

ANULOHET aktvendimi nr.07.3/589,736 datës 15.07.2014 i Doganës së Kosovës në Prishtinë, dhe lënda kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje

A R S Y E T I M

Me aktvendimin kontestues e paditura Dogana e Kosovës në Prishtinë ka refuzuar kërkesën e paditësit për rishqyrtimin e vendimeve R4572/08.04.2014, R4634/09.04.2014, R4805/11.04.2014, R4898/12.04.2014, R4964/14.04.2014, R7466/17.05.2014 të ZBD Merdarë, si të pa bazuar.

Paditësi B. shpk nga F., me padinë e paraqitur në Gjykatë, me datë 21.08.2014, ka inicuar konfliktin administrativ kundër të paditurës Dogana e Kosovës në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar nga gjykata të aprovohet padia në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës respektivisht në bazë të vlerës së deklaruar të transaksionit dhe mjetet e paguara më tepër të na kthehen në xhirollogarinë bankare.

Në padinë e tij dhe përmes përfaqësuesit të autorizuar në seancën e shqyrtimit kryesor, paditësi deklaroi: zyra doganore ka ngritur bazën doganore pa i çmuar drejt provat e prezantuar me rastin e vlerësimit të mallit në Deklaratat Unike Doganore për zhdoganimin e mallit lëndor në kuptim të vlerës, në vështrim të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës vlera e mallrave të importuara do të jetë vlera e transaksionit që do të thotë çmimi realisht i paguar ose që duhet paguar për mallrat që shiten për eksport drejt Kosovës. Të gjitha dokumentet e prezantuar janë të harmonizuara me nenin 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 dhe janë të harmonizuara në kuptim të vlerës së mallit. Gjatë rivlerësimit të mallit lëndor Dogana e Kosovës ka vepruar në kundërshtim me metodat e vlerësimit sipas dispozitave të nenit 33-35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109. Zyra doganore në Podujev ka qenë dashtë ta ket parasysh se malli lëndor nuk është i paketuar në thas por është refuzu dhe është në logjikën ekonomike se ky mall ka një kosto më të ulët se sa malli që është në paketim, po ashtu

edhe sasit e mëdha që paguhen të jep me kuptu se çmimi i blerjes është më i ulët. Përfaqësuesi i autorizuar në seancën e shqyrtimit kryesor thekson se mbetem prapa padisë dhe kërkesëpadisë dhe kërkoj që DUD-at kontestues të mirren në baza reale të faturës për shkak se pa arsye na është bërë rritja e bazës doganore meqenëse për të njëjtat DUD-a posedojmë faturën, transaksionin bankar dhe kontratën e bashkpunimit, çka mendoj që është bazë për zhdoganim të rregullt siç e kërkon Kodi Doganor dhe i Akcizave të Kosovës.

Përfaqësuesja ligjore e palës së paditur Ministria e Drejtësisë në përgjigje në padi datës 24.02.2016 deklaroi: e kundërshtojmë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, për arsye se zyra doganore ka vepruar drejtë kur gjatë vlerësimit të mallit është bazuar në metodën e gjashtë të vlerësimit neni 35 i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës respektivisht në bazë të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës pasi që këto të dhëna janë marrë nga Sektori i Vlerës, vlerësim ky i cili është bërë duke i shfrytëzuar informatat e marra nga zhdoganimet e rregullta nëpër degë. Zyra doganore ka vepruar drejt kur ka përcaktuar vlerën për mallin lëndor me faktin se ky vlerësim është në harmoni edhe me çmimin e përcaktuar nga sektori kompetent-sektori i vlerës. Dogana e Kosovës me qëllim të përgjigjes së pretendimeve të paditësit në procedurë ka kërkuar nga sektori i vlerës të përcaktoj çmimin e mallit të cilët me datë 17.07.2014 kanë konfirmuar se çmimi i përcaktuar nga zyra doganore është çmim real se referenca e aplikuar me rastin e rivlerësimit të mallit është e drejtë. Për këtë arsye Dogana e Kosovës pas rishqyrtimit të kërkesës me shkresat e bashkangjitura në lëndë ka konstatuar se malli nuk mund të vlerësohet sipas dispozitave ligjore nga neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. E paditura Dogana e Kosovës duke u bazuar në thëniet e cekura si më lartë i propozon gjykatës që pas administrimit të provave, të marr aktgjykim me të cilin e refuzon në tërësi si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata ka shqyrtuar këtë konflikt administrativ gjyqësor konform dispozitave të nenit 41 të LKA-së, për arsye se përfaqësuesja ligjore e paditurës edhe pse ka pranuar thirrjen për seancë me datën 01.09.2016, ajo nuk ka marr pjesë dhe nuk ka arsyetuar mos ardhjen në seancë (provë: fletëdërgesa e pranuar nga Ministria e Drejtësisë-Avokatura Shtetërore dt.01.09.2016).

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës; 23.09.2016, ka administruar provat relevante dhe atë: përgjigja në padi e dt.24.02.2016 nga Ministria e Drejtësisë, aktvendimi nr.07.3/589,736 i dt.15.07.2014 nga Dogana e Kosovës, Deklaratat unike doganore, fakturat e mallit, kontrata e shitblerjes, procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallit nga Zyra doganore, transferi bankar i dt.28.04.2014, deklarata e shtetit eksportues, transferi bankar i dt.13.01.2014 nga N. Banka, transferi bankar i dt.14.10.2014 nga T. Bank.

Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 81G të Ligjit nr.04/L-102, në seancën e mbajtur me datë 23.09.2016, vlerësoi ligjshmërinë e aktvendimit kontestues, thëniet në ankes-padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë konflikt administrativ, deklarimeve në seancën e shqyrtimit kryesor, dhe konstatoi se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar andaj vendosi që lëndën ta kthej në rishqyrtim për këto arsye:

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues gjykata vlerëson se në asnjë rast e paditura nuk ka shqyrtuar kërkesën e paditësit lidhur me vlerën e dokumentacionit të mallit lëndor të paraqitur gjatë zhdoganimit të mallit dhe në procedurën e ankesave, por mallin lëndor e ka vlerësuar me metodën e 6 të vlerësimit neni 35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave respektivisht sipas të dhënave të disponueshme të Doganës së Kosovës pasi këto të dhëna janë marrë duke i shfrytëzuar informatat e marra nga zhdoganimet e rregullta nëpër degë si dhe çmimet nga të dhënat e disponueshme të Doganës së Kosovës.

Edhe pse Sektori për Rishqyrtimin e Vendimeve në vendimin e kundërshtuar i ka lexuar provat që paditësi ia ka bashkangjitur lëndës si: deklarata unike doganore, faturat përcjellëse të mallit, transferi bankar, deklarata eksportuese, procesi mbi përcaktimin e vlerës së mallrave, etj, megjithatë e paditura nuk e shqyrton fare validitetin e dokumentacionit të mallit lëndor të paraqitur nga paditësi i cili ka iniciuar këtë proces administrativ me kërkesën e tij, porse e paditura referohet direkt në të dhënat e disponueshme që posedon për llojin e mallit lëndor dhe për ti konfirmuar çmimet e të dhënave të disponueshme e paditura përmes sektorit të vlerës konfirmon se çmimi i përcaktuar nga zyra doganore është çmim real dhe se referenca e aplikuar me rastin e vlerësimit është e drejtë. Në vendimin kontestues nuk përmendet fare se sa është çmimi i mallit lëndor sipas të dhënave të disponueshme që disponon Dogana e Kosovës. Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Sektori i Vlerës-Dogana e Kosovës me shkresën zyrtare dt.17.06.2014 e ka informuar paditësin se vlera e mallit lëndor sillet nga 250€/t e më lartë dhe se me rastin e importeve të paditësit kur kemi të bëjmë me mallin e deklaruar “refuz” është një zbritje e vlerës në masën prej 10% në raport me mallin e paketuar.

Pala paditëse i ka prezentuar gjykatës dokumentacionin përcjellës të mallit lëndor që është paraqit në procedurën administrative të ankesave si: fakturat e mallit, kontrata e shitblerjes e lidhur mes paditësit dhe furnizuesit të mallit lëndor dt.12.10.2013, 13.01.2014, 16.05.2014, transferi bankar i dt.28.04.2014 Banka T., me të cilën është bërë pagesa për faturat e mallit (janë cekur numrat e faturave), transferi bankar i dt.13.01.2014 nga N. Banka, transferi bankar i dt.14.10.2014 nga T. Bank, deklarata e shtetit eksportues.

Duke vlersuar një gjendje të tillë ku e paditura nxjerr vendim ligjor në bazë të kërkesës së palës dhe nuk shqyrton fare pretendimet e paditësit lidhur me vlerën e deklaruar dhe dokumentacionin përcjellës të mallit të kontestuar nga zyra doganore, gjykata konsideron se në vendimin kontestues e paditura nuk ka vepruar në vështrim të dispozitave ligjore të nenit 77 të Ligjit 02/L-28 për Procedurën Administrative, ku parashihet që: në vendimin përfundimtar, organi administrativ kompetent vendos për të gjitha çështjet e ngritura gjatë zhvillimit të procedimit.

Gjykata me qëllim të konstatimit të drejt të çështjes, me prova materiale shtesë, i duhet sqarim plotësues, verifikim dhe sigurim i provave shtesë, në mënyrë që konstatimi i dhënë në arsyetim të aktvendimit të kontestuar të mbështetet në dispozita ligjore dhe prova materiale. Në procedurën e rishqyrtimit gjykata e obligon të padituren që para të aplikoj metodën e gjashtë (6) të vlerësimit neni 35 i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, të shqyrtoj paraprakisht metodat paraprake të vlersimit nga neni 33-35 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, ashtu që të verifikoj validitetin e dokumentacionit të mallit lëndor që e ka paraqit paditësi në procedurën administrative të ankesave në kuptim të harmonizimit të vlerës së mallit konform nenit 123 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 për implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109, dhe të konstatoj se a janë plotsuar kushtet ligjore për ta pranuar vlerën e transaksionit në bazë të nenit 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës. Në rast të dyshimit të vlerës reale të mallit gjykata e udhëzon të padituren që konform nenit 92 par.2 të Udhëzimit Administrativ 11/2009 për implementimin e Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës, të kërkoj të dhëna shtesë nga pala paditëse për ta konfirmuar nga eksportuesi vlerën e deklaruar të mallit si dhe të verifikoj edhe përmes informatave zyrtare nga shteti eksportues Serbi, se a është paraqit vlera reale e mallit lëndor sipas Deklaratave Unike Doganore kontestuese. Gjithashtu e paditura të vlersoj faktet se në periudhën e afërt kohore a kemi mallra identike apo të ngjashme të cilave iu është pranuar vlera e transaksionit sipas nenit 34 par.2 pika (a) dhe (b) të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës nr.03/L-109. Në rast se nuk dëshmohet se është paguar vlera e mallit lëndor sipas faturave përcjellëse të mallit lëndor, nuk gjenden prova se kemi transaksione të ngjashme me mallin kontestues, atëher e paditura

obligohet që me rastin e aplikimit të metodës së 6 të vlersimit nga neni 35 i Kodit Doganor dhe i Akcizave të sqarohet në vendimin e ri se sa është çmimi i mallit lëndor sipas të dhënave që disponon Dogana e Kosovës, dhe se çmimet referuese nga të dhënat e disponueshme nga cilat burime rrjedhin, nga çmimet e tregut vendor, apo nga importet e mallrave identike apo të ngjashme, dhe këto informata t,ia bashkangjes lëndës. Të verifikoj se a janë aplikuar drejt çmimet e mallit lëndor të rekomanduara nga Sektori i Vlerës sipas shkresës zyrtare dt.17.06.2014

Duke pasur parasysh konstatimet e sipërcekura, gjykata konkludon se në këtë konflikt administrativ ekzistojnë të meta të cilat e pengojnë vlerësimin e ligjshmërisë së vendimit të kontestuar, ku ka rezultuar të mos dihen arsyet e mos vlerësimit të dokumentacionit të mallit lëndor, kur paditësit i është refuzuar kërkesa për rishqyrtimin e vendimeve. Andaj në këtë drejtim gjykata bazuar në autorizimet nga neni 81.I par.2 pika 2.2 të Ligjit nr.04/L-102, neni 43 par.2 të LKA-së e detyron organin e paditur Dogana e Kosovës në Prishtinë, që në riprocedurë të veprave sipas vërejtjeve të dhëna në arsyetim të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se nuk janë vlerësuar në mënyrë të drejtë të gjitha faktet që kishin me ndikuar në vendosjen e drejtë të çështjes.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
Departamenti për çështje administrative-Divizioni Fiskal
A.nr.1668/14 datë 23.09.2016

Gjyqtari,
Krenar Berisha

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 60 ditësh nga marrja e të njëjtit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate.